

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. 50.02 Nr. i Prot. 5450-2/25
Org. Unit Prot. No. 5450-2/25
Nr. i Faqeve -05- Data: 03.11.25
Br. Stranica No. Pages
PRISHTINË / A No. 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	22.10.2025
REFERENC-Ë:	25/5450/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Ballkan Petrol" Sh.p.k. Gërlicë, Ferizaj, Stacion i karburanteve, Suhadoll, Graçanicë
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/ a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.25/5450/MMPHI, për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Ballkan Petrol" Sh.p.k. Gërlicë, Ferizaj, për veprimtarinë: Stacion i karburanteve, Suhadoll, Graçanicë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, vizitës në terren, një sërë takimesh dhe mbajtjes së debatit publik, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/5450/MMPHI

Datë: 22.10.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenin 13, të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

Vendim

Aprovohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore, me Nr.Prot.25/5450/MMPHI, e operatorit "Ballkan Petrol" Sh.p.k. Gërlaçë, Ferizaj, për veprimtarinë: Stacion i karburanteve, me kapacitet të rezervuarëve si në vijim: $V = 3 \times 50,000$ litra dhe $V = 2 \times 25,000$ litra naftë dhe benzinë, në ngastrat kadastrale: Nr.P-73409082-00040-9, P-73409082-00040-12, zona kadastrale Suhadoll, Graçanicë.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahet shtresa mbrojtëse e rezervuarëve nëntokësorë kundër rrjedhjeve, që janë të pajisur me sensorë që lajmërojnë rrjedhjen, për ta parandaluar ndodjen e tokës dhe ujërave nëntokësore;


- Të mirëmbahet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza;
- Të mirëmbahen kolektorët e sipërfaqes operationale, që janë të lidhur me seperatorin në vajrave;
- Të mirëmbahet sipërfaqja operationale, e cila është e betonuar dhe izoluar;
- Të mirëmbahen dhe zbrazen rregullisht kontejnerët, sipas kontratës me kompaninë e mbeturinave;
- Të pastrohet dhe mirëmbahet seperatori i vajrave dhe gropa septike, për ta parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore;
- Të monitorohen ujërat, që dalin pas trajtimit në seperatorin e vajrave, para shkarkimit në rrjetin e kanalizimit, raporti i analizave të dërgohet në MMPHI/AMMK-së;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisore;
- Të mirëmbahen sipërfaqet gjelbëruese me drunj dekorativ dhe bimë barishtore;
- Të implementohet plani aksional për aksidente;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoni MMPHI-në;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/5450/MMPHI, për t'u pajisur me Leje Mjedisore, të operatorit "Ballkan Petrol" Sh.p.k. Gërlicë, Ferizaj, për veprimtarinë: Stacion i karburanteve, me kapacitet të rezervuarëve si në vijim: $V = 3 \times 50,000$ litra dhe $V = 2 \times 25,000$ litra naftë dhe benzinë, në ngastrat kadastrale: Nr.P-73409082-00040-9, P-73409082-00040-12, zona kadastrale Suhadoll, Graçanicë, MMPHI konstaton se operatori i ka plotësuar kushtet administrative dhe mjedisore për t'u pajisur me Leje Mjedisore.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810080036, datë: 21.12.2017, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;



- Pëlqim Mjedisor, Nr.: 22/6432/1-ZSP/274/22, datë: 29.12.2022, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Pëlqim, Nr.1999/22, datë: 28.10.2022, të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent;
- Leje Ndërtimore, Nr. II 154/22, datë: 23.01.2023, të lëshuar nga Komuna e Graçanicës

Andaj, duke u bazuar në të lartcekuar, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **aprovon** kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore, të operatorit të lartcekur.


Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.



Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Graçanicë;
- DMM-së;
- DLLM-së;
- AMMK-së
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.